



KUVENDI I SHQIPËRISË
Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 27.01.2020

Dokument parlamentar

**RAPORT
PËR**

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 8561, DATË 22.12.1999, “PËR SHPRONËSIMET DHE MARRJEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM TË PASURISË, PRONË PRIVATE, PËR INTERES PUBLIK”, TË NDRYSHUAR”

- **Hyrje**

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit, shqyrtoi projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar”, në mbledhjen e datës 27 janar 2020.

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin caktoi deputetin Arben Pëllumbi relator për shqyrtimin e këtij projektligji.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t’u dhënë shpjegime pyetjeve të deputetëve, ishte Z. Artan Shkreli, Zëvendësministër në ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Z. Enea Karakaci, drejtor i Drejtorisë Juridike në këtë ministri.

- **Baza kushtetuese e projektligjit**

Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar”, është një nismë e Këshillit të Ministrave, e cila i paraqitet për shqyrtim Kuvendit mbështetur në nenet 78, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës.

Miratimi i këtij projektligji kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 3 e Rregullores së Kuvendit.

- ***Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit***

Ndryshimet e propozuara synojnë rregullime në ligjin ekzistues nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik të ndryshuar”.

Këto rregullime janë të natyrës procedurale dhe vijnë si rezultat i problematikave që janë hasur në praktikë, gjatë implementimit të ligjit aktual për shpronësimet, të tilla si: mungesa e planifikimit paraprak të shpronësimeve; zgjatje e afatit të procedurës, e cila sjell vonesa dhe bllokim të zbatimit të projekteve dhe investimeve; borxhi i akumuluar për shkak të vonesave në pagesa të subjekteve të shpronësuara; mungesa e negociatave dypalëshe me subjektin që do të shpronësohet; mosrespektimi i dispozitave ligjore në lidhje me mënyrën e pagesës së subjektit të shpronësuar; proceset gjyqësore me subjektet e shpronësuara (me objekt ndryshim të masës së vlerësimit të shpronësimit).

Qëllimi i ndryshimeve të propozuara është, pikërisht, rregullimi i procedurave të shpronësimit, me synim planifikimin si dhe përqendrimin e kompetencave të institucionit përgjegjës për shpronësimet. Për këtë qëllim propozohet ngritja e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin, e cila do të jetë institucion në varësi të ministrit përgjegjës për zhvillimin urban.

Agjencia Shtetërore për Shpronësim do të jetë institucioni përgjegjës për procedurat e shpronësimit, i cili do të shqyrtojë kërkesat për shpronësim, tashmë, në një kohë më të shkurtër dhe do të realizojë procedurat e shpronësimit në mënyrë më eficiente, duke garantuar në shkallë më të lartë edhe të drejtat e personave që shpronësohen.

Projektligji përcakton Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), si institucion përgjegjës për përcjelljen për miratim në Këshillin e Ministrave të propozimeve të paraqitura nga ASHSH, si dhe personat juridikë, publikë ose privatë, që kanë interes publik për realizimin e shpronësimit ose marrjes në përdorim të përkohshëm të pasurive pronë private.

- ***Vlerësimi i Ligjshmërisë Kushtetuese dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi***

Projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe me legjislacionin përkatës që rregullon këtë fushë në vendet anëtare të BE-së.

Në aspektin procedural projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

- ***Diskutimi në Komision***

Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar”, është shqyrtuar nga Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 27 janar 2020.

Relatori vlerësoi nismën e ndërmarrë për propozimin e projektligjit, duke e konsideruar atë si një mekanizëm efektiv për adresimin dhe zgjidhjen e problematikave lidhur me shpronësimet, të cilat ligji ekzistues nuk ka mundur t’i zgjidhë.

Relatori vlerësoi rolin që do të luajë Agjencia Shtetërore për Shpronësim (ASHSH), si institucioni përgjegjës për trajtimin e procedurave të shpronësimit. Nëpërmjet funksioneve që ligji i jep ASHSH-së, do të mundësohet realizimi i procedurave të shpronësimit në mënyrë më eficiente, pasi do të shkurtohet koha e trajtimit të tyre, do të garantohen në një shkallë më të lartë të drejtat e personave që shpronësohen, si dhe do të ulet numri i proceseve gjyqësore me subjektet e shpronësuara.

Diskutimet e anëtarëve të Komisionit, për të cilat u bënë edhe pyetje propozuesve, u përqendruan kryesisht në çështje të tilla si: natyra e problematikave të evidentuara në ligjin ekzistues, të cilat sollën nevojën e hartimit të ndryshimeve të propozuara; avantazhet që sjell krijimi i ASHSH-së; natyra e çështjeve dhe problematikave që do të trajtojnë ajo; nëse kompetencat e saj do të lidhen edhe me trajtimin e kërkesave për shpronësimet që kryhen nga njësitë e qeverisjes vendore; buxhetin e saj; mënyrën e trajtimit të çështjeve gjyqësore që kanë filluar, apo janë në proces.

Përfaqësuesit e ministrisë shpjeguan se problematikat e evidentuara gjatë zbatimit të ligjit ekzistues, që sollën nevojën e hartimit të ndryshimeve, konsistojnë në: mungesën e planifikimit paraprak të shpronësimeve; zgjatjen e afatit të procedurës, e cila sjell vonesa dhe bllokim të zbatimit të projekteve dhe investimeve; akumulimin e borxhit për shkak të vonesave në pagesa të subjekteve të shpronësuara; mungesën e negociatave dypalëshe me subjektin që do të shpronësohet; mosrespektimin e dispozitave ligjore në lidhje me mënyrën e pagesës së subjektit të shpronësuar; numrin e lartë të proceseve gjyqësore me subjektet e shpronësuara (me objekt ndryshim të masës së vlerësimit të shpronësimit).

Barrën më të madhe të problematikave me procedurat e shpronësimit e mban ministria që mbulon zhvillimin urban, ministria e brendshme, por edhe ajo e kulturës, duke krijuar pasiguri tek entet shtetërore, por edhe tek subjektet private.

Pikërisht, me qëllim rregullimin e procedurave të shpronësimit, me synim planifikimin si dhe përqendrimin e kompetencave të institucionit përgjegjës për shpronësimet, projektligji propozon ngritjen e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin, e cila do të jetë institucion në varësi të ministrit përgjegjës për zhvillimin urban.

Krijimi i kësaj agjencie do të shërbejë si një mekanizëm i ri ligjor i cili do të përqendrojë procedurat në një institucion të vetëm, duke saktësuar aspektet procedurale në fushën e shqyrtimit dhe trajtimit të

kërkesave për shpronësim; do të reduktojë reagimin negativ të subjekteve duke negociuar dhe sqaruar me secilin prej tyre për kriteret, mënyrat, vlerësimin dhe gjithë procesin e shpronësimit në tërësi; do të ulë numrin e ankesave në gjykatë nga subjektet që do të shpronësohen; do të ulë borxhin deri në reduktimin final të tij duke parashikuar dhe mundësuar pagesën me këste ndaj subjekteve të shpronësuar.

ASHSH do të ketë në përbërjen e saj edhe një trupë të specializuar që do të merret me ndjekjen ligjore të çështjeve të shpronësimeve, me kohë të plotë, dhe do të kryejnë edhe ekspertizën teknike për vlerësimin e rasteve konkrete, pasi, edhe problemet në kuadër të procesit të rindërtimit do të rrisin nivelin e kërkesave për shpronësime.

ASHSH do të kryejë procedurat e shpronësimit, ashtu siç parashikohet në ligjin ekzistues, duke ndërmjetësuar dhe trajtuar edhe kërkesat për shpronësime që vijnë nga njësitë e qeverisjes vendore. Buxheti i ASHSH-së do të jetë pjesë e buxhetit vjetor të planifikuar për ministrinë që mbulon zhvillimin urban.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni, me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, miratoi, në parim, nen për nen dhe në tërësi projektligjin dhe u shpreh dakord për kalimin e tij për votim në seancë plenare.

RELATOR

KRYETAR

Arben PËLLUMBI

Niko PELESHI